



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 03.06.2013
Nr. 0204-678

PËR: Isa Mustafa, Kryetar i Komunës së Prishtinës
Sami Hamiti, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË PRISHTINËS, 01Nr.353-74919, Pranuar me datë, 23.05.2013.

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit 01.Nr.353-74919, të miratuar me datë 16.05.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi 01.Nr.353-74919, për dhënien e qendrës kulturore rekreative në Gërmi në shfrytëzim të përkohshëm NPL „Sport Marketing”Sh A në Prishtinë.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL-së,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL -së
Udhëheqësove të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 03.06.2013
br. 0204-678

Za: Isa Mustafa, Gradonačelnik opštine Priština
Sami Hamiti, Predsedavajući Skupštine opštine Priština

Predmet: Potvrda zakonitosti odluke opštine Priština „ 01br.353-74919, primljeno dana
, 23.05.2013.

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke 01.br.353-74919, odobreno dana 16.05.2013, POTVRĐUJE zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Odluka 01.br.353-74919, za davanje rekreativnog kulturnog centra u Germiju na privremeno korišćenje JLZ „Sport Marketing“ A D u Prištini.

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 16.05.2013, miratoi këtë

VENDIM — *ni kundërtuar me Ligjin Nr. 164/04*
PËR DHËNIEN E QENDRËS KULTURORE REKREATIVE NË GËRMI NË SHFRYTËZIM TË PËRKOSSHËM NPL "SPORT MARKETING" SH A NË PRISHTINË

I.
Miratohet Vendimi për dhënie e Qendrës Kulturore Rekreative në Gërmë në shfrytëzim të përkohshëm NPL "Sport Marketing" SH A në Prishtinë.

II.
Qendra e dhënë në shfrytëzim të përkohshëm, sipas pikës I të këtij vendimi, përfshin pjesën e parcelës kadastrale nr. 214/1, Zona kadastrale Sofali, në sipërfaqe prej 19 798 m² dhe pjesën e parcelës kadastrale nr. 234, Zona kadastrale Sofali, në sipërfaqe prej 202 m², si dhe objektin, në sipërfaqe prej 309.05 m², 13 kampshtëpiza të dimensionit prej 29.25 m², në sipërfaqe prej 380.25 m², të vendosura në parcelat e cekura.

III.
Qendra e cekur në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim për 10 vjet.

IV.
Qëllimi i dhënies së Qendrës në shfrytëzim të përkohshëm, të cekur në pikën I të këtij vendimi, është funksionalizimi i Qendrës Kulturore Rekreative në Gërmë, me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve të edukimit, kulturës dhe rekreacionit.

V.
NPL "Sport Marketing" SH A, është e obliguar që lokacionin e dhënë në shfrytëzim ta mirëmbajë në gjendje të rregullt dhe, pas kërkesë së Komunës, ta kthejë në posedim të saj.

Faqe 1 nga 2

VI.

Në rast shitjeje ose likuidimi të ndërmarrjes gjatë kohëzgjatjes së dhënies në shfrytëzim, prona e dhënë në shfrytëzim i kthehet pronarit.

VII.

Kushtet tjera të dhënies në shfrytëzim të përkohshëm do të rregullohen me marrëveshje të veçantë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe NPL "Sport Marketing" SH A.

VIII.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria e Financave dhe e Pronës.

IX.

Ky vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve të Komunës dhe në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 353-74919, më 21.05.2013

